MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË E SHËRBIMIT PYJOR, DURRËS

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Drejtorinë e Shërbimit Pyjor, Durrës, me objekt "Mbi veprimtarinë ekonomiko-financiare dhe mbi administrimin e pyjeve, kullotave dhe fondeve publike të vëna në dispozicion" për periudhën 01.01.2008 deri 31.12.2010, dhe masat për përmirësimin e gjendjes janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 25 datë 05.03.2012.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23/12/1997 "Për kontrollin e Lartë të Shtetit", ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 1/6/2000, me shkresën nr. 345/6, datë 05.03.2012, dërguar Z. [redacted], Drejtor i Shërbimit Pyjor, Durrës Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. Propozime për ndryshime apo përmirësime në legjislacionin në fuqi

1. Duke gjykuar se statusi juridik i Zonës së Mbrojtur me emërtimin Park Natyror në vendin e quajtur Rrushkull, rrethi Durrës, me sipërfaqe 650 ha, (gjendje fundi i vitit 2010-të) është i përcaktuar me urdhrin e ish-ministrit të Bujqësisë nr. 2 datë 26.12.1995;

- Duke konstatuar se shpallja e një zone të Mbrojtur dhe zonimi i saj bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave me propozimin e Ministrit përgjegjës për mjedisin (sipas përcaktimeve neni 13, pika 1 e ligjit nr. 8906, datë 06.06.2002, për "Zonat e Mbrojtura" propozojmë:

Ministria e Mjedisit Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave të bëjë rivlerësimin Mjedisor të Parkut Natyror, në vendin e quajtur Rrushkull, rrethi Durrës, për ta shpallur "Zonë të Mbrojtur" dhe kategorinë përkatëse të mbrojtjes, trajtuar më hollësisht në pikën VII. B të Raportit Përfundimtar të Kontrollit.

Deri në fund të vitit 2012

2. Duke gjykuar se, për hartimin e planit të mbarështimit të Pyjeve (pronë shtetërore dhe komunale) ka përcaktime dhe procedura të qarta ligjore të shprehura në nenin 5 pikat 4, 5, 6 të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005 "Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor";

-Duke gjykuar se, për hartimin e planit të mbarështimit janë shpenzuar shuma të konsiderueshme monetare;

- Duke konstatuar se, zbatimi i planit të mbarështimit nuk realizohet dhe për këtë nuk ka struktura që legjislacioni t`i ngarkojë për zbatim, propozojmë:

Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave t`i propozojë Këshillit të Ministrave, ngarkimin apo ngritjen e një organizmi (strukture), ku të jenë të përcaktuara detyrat, funksionet dhe përgjegjësitë në lidhje me zbatimin e planeve të mbarështimit të Pyjeve, trajtuar më hollësisht në pikën VII. A të Raportit Përfundimtar të Kontrollit.

Deri në fund të vitit 2012

B. MASA ORGANIZATIVE

1. Nga Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Durrës, të merren masa për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga kontrolli i mëparshëm i Auditit të brendshëm të MMPAU-së, bazuar në Urdhrin e Ministrit nr. 343/1, datë 16.06.2010 "Përfundimet e auditimit të ushtruar në DSHP, Durrës", në Urdhrin nr. 70, datë 18.04.2006 të Kryeministrit "Për

masat në zbatim të rekomandimeve të KLSH, Auditit të brendshëm dhe Departamentit të kontrollit të brendshëm administrativ dhe antikorrupsion, në Këshillin e ministrave, në Institucionet në varësi të Kryeministrit a të ministrave ", të cilat rezultuan të pazbatuara, trajtuar në pikën I të Raportit Përfundimtar të Kontrollit.

Menjëherë

2. Nga Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Durrës, për të shmangur spontanitetin në realizimin faktik të buxhetit, të merren masa konkrete si në hartimin dhe zbatimin e buxhetit për vitet në vazhdim, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" si dhe udhëzimeve të dala nga Ministria e financave për çdo vit, trajtuar në pikën II të Raportit Përfundimtar të Kontrollit.

Në vazhdimësi

3. Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Durrës dhe administrata e zonës së mbrojtur e Parkut Natyror –Rrushkull, të marrin masa për përfundimin e planit të menaxhimit të Parkut Natyror prej 650 ha, në përputhje me nenin 15, pika 1 e ligjit nr. 8906, datë 06.06.2002 "Për Zonat e Mbrojtura", me ndryshime, trajtuar më hollësisht në pikën VII. B të Raportit Përfundimtar të Kontrollit.

Deri në fund të vitit 2012

4. Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Durrës, në kontratën vjetore për dhënien me qira të Parkut Natyror Rrushkull "Për mbarështimin e faunës së egër", për sipërfaqen prej 650 ha, subjektit "Perla sh.p.k", të pasqyrojë në mënyrë të zbërthyer të dhënat që përmban raporti teknik i hartuar nga subjekti si dhe kushtet e vendosura në lejen e integruar të dhënë nga MMPAU me vendim nr. 1, datë 26.02.2007, trajtuar më hollësisht në pikën VII. B të Raportit Përfundimtar të Kontrollit.

Për çdo vit në lidhjen e kontratës

5. Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Durrës, t`i kërkojë subjektit "Perla sh.p.k", që plani dhe zbatimi i monitorimit dhe biomonitorimit, që do të kryhet nga ekspertë të pavarur për llogari të saj, të jetë konkret, i bazuar në kushtet e vendosura në lejen e integruar dhe përcaktimet e bëra në projektin teknik, trajtuar më hollësisht në pikën VII. B të Raportit Përfundimtar të Kontrollit.

Për çdo vit

6. Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Durrës, në bashkëpunim me organet e pushtetit vendor dhe organizma të tjerë, të kryejë studimin: "Mbi mundësitë e shtimit të sipërfaqeve pyjore me funksione mbrojtës dhe rekreativ", sidomos përgjatë vijës bregdetare, studimin: "Mbi masat për kufizimin dhe parandalimin e erozionit detar dhe avancimin e detit në brendësi të tokës", trajtuar më hollësisht në pikën VII.A dhe VIII të Raportit Përfundimtar të Kontrollit.

Deri më 31.12.2012

7. Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Durrës, të marrë masa për sigurimin e informacionit të nevojshëm nëpërmjet zbatimit të sistemit të evidencave nga komunat, për pyjet komunal dhe privatë, mbi mënyrën e administrimit, zhvillimit, trajtimit dhe

shfrytëzimit te fondit pyjor, komunal dhe privat, trajtuar më hollësisht në pikën VII. A dhe VIII të Raportit Përfundimtar të Kontrollit.

.

Brenda tre mujorit të parë 2012 dhe vazhdimisht

8. Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Durrës, në përputhje me nenin 17 dhe paragrafin e fundit të pikës 3, të nenit 18 të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005, me ndryshime. t`i propozojë MMPAU heqjen nga fondi pyjor:

a. Të sipërfaqes prej 118.2 ha, sipërfaqe që bën pjesë në ekonominë pyjore Shijak- Maminas, e cila ka kaluar në zgjerimin e vijës kufizuese të qytetit të Durrësit me vendim nr. 1, datë 02.09.1999 të KRRTRSH-së;

b. Të sipërfaqes prej 12 ha, që i përket ekonomisë pyjore Rrotull, për të cilën me vendim nr. 4, datë 16.09.2000 të KRRTRSH është miratuar studimi urbanistik dhe sheshi i ndërtimit për zonën turistike te Gjirit të Lalëzit dhe me vendimin nr. 10, datë 19.10.2001 të KRRTRSH, është dhënë leja e ndërtimit, trajtuar më hollësisht në pikën VII të Raportit Përfundimtar të Kontrollit.

Deri më 31.03.2012

9. Nga Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Durrës, në hartimin e pasqyrave financiare të vitit 2011 të pasqyrohet gjendja më 31.12.2010, për :

- Mjetet e transportit në vlerën 6 112 432 lekë;
- Klientë në vlerën 136 569 lekë;
- Debitorë të ndryshëm në vlerën 29 567 489 lekë;
- Fondet e veta në vlerën 25 644 021 lekë;
- Të ardhurat në vlerën 9 653 225 lekë.

Trajtuar më hollësisht në pikën IV të Raportit Përfundimtar të Kontrollit.

Menjëherë

10. Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Durrës, për realizimin e shitjes publike nëpërmjet procedurës së ankandit nga autoriteti shitës, të zbatojë rregullat e përcaktuara në Ligjin nr. 9874, datë 14.02.2008 "Për Ankandin Publik" i ndryshuar, trajtuar më hollësisht në pikën V. A të Raportit Përfundimtar të Kontrollit.

Vazhdimisht

11. Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Durrës, në fillim të çdo viti, të bëjë planifikimin për natyrën, llojet, sasinë e mallrave që do të prokurohen dhe procedurën e prokurimit që do të ndiqet.

Bazuar në Kreun I, pika 3/b të VKM nr. 1, datë 10.01.2007, me ndryshime, brenda datës 20 janar të çdo viti, titullari DSHP-së, të dërgojë një kopje të regjistrit të parashikimeve të prokurimit në MMPAU, trajtuar më hollësisht në pikën V. B të Raportit Përfundimtar të Kontrollit.

Menjëherë dhe çdo vit

12. Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Durrës, gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit me vlera të vogla, të përdorë dokumentet standardë të miratuara nga Agjencia e

Prokurimeve Publike me udhëzimin nr. 2, datë 18.02.2008, trajtuar më hollësisht në pikën V. B të Raportit Përfundimtar të Kontrollit.

Menjëherë dhe vazhdimisht

13. Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Durrës, në mënyrë të menjëhershme të ndalojë blerjen e karburantit me prokurim të drejtpërdrejtë, pasi bazuar në VKM 53, datë 21.01.2009 (me shtesa), ngarkohet Ministria e Brendshme, si organ qendror blerës, për kryerjen e procedurave të prokurimit, në emër dhe për llogari të Kryeministrisë, ministrive, institucioneve në varësi të tyre, trajtuar më hollësisht në pikën V. B të Raportit Përfundimtar të Kontrollit.

Menjëherë

14. Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Durrës, për blerjen e kancelarive/shtypshkrimeve, të mos përdorë pjesëtimin e vlerës së parashikuar për shpenzimet e vitit përkatës me qëllim shmangien e procedurave konkurruese të prokurimit, trajtuar më hollësisht në pikën V. B të Raportit Përfundimtar të Kontrollit.

Menjëherë

15. Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Durrës, në përputhje me pikën "e", neni 510 dhe pikën "ç", neni 511 i Ligjit nr. 8116, datë 29.03.1996, "Kodi i Procedurës civile", pas skadimit të afateve të apelimit në rrugë administrative dhe gjyqësore për subjektet e gjobitura, t'i drejtohet gjykatës, për "lëshimin e urdhrit të ekzekutimit" për gjobat e vendosura nga inspektorët, trajtuar më hollësisht në pikën X të Raportit Përfundimtar të Kontrollit.

Menjëherë

16. Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Durrës, në përputhje me pikën b, neni 56, të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 "Kodi i Procedurave Administrative", t`u dërgojë në rrugë zyrtare fletë-thirrjet shtetasve, për pjesëmarrje në shqyrtimin e kundravajtjeve të kryera prej tyre, trajtuar më hollësisht në pikën X të Raportit Përfundimtar të Kontrollit.

Menjëherë

17. KVKA pranë Drejtorisë së Shërbimit Pyjor, Durrës, kur pas përfundimit të shqyrtimit të kundërvajtjes administrative konstaton shkaktim dëmi, si pasojë e kundërvajtjes, të mbajë me akt administrativ më vete shpërblimin e dëmit, veprim ky i bazuar në pikën 1, nenin 12 i ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për Kundravajtjet Administrative", trajtuar më hollësisht në pikën X të Raportit Përfundimtar të Kontrollit.

Menjëherë

18. Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Durrës, bazuar në ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994 "Kodi Civil", Kreu i III "Shpërblimi i Dëmit", neni 640, t`i drejtohet gjykatave respektive, duke kërkuar dëmshpërblimin nga shtetasit, të cilët kanë shkaktuar dëme në fondin pyjor, trajtuar më hollësisht në pikën X të Raportit Përfundimtar të Kontrollit.

Menjëherë

C. MASA ZHDËMTIMI

1. Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Durrës, mbështetur në nenin 27 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "Për Kodin e Punës", me ndryshime, të kryejë kontabilizimet dhe të bëjë ndalesat për 27 persona në vlerën 614 796 lekë, si më poshtë:

a. Për 24 persona në vlerën 541 625, për përfitim të padrejtë për orë pune mbi kohën normale të punës, të pa miratuar nga Ministri, në kundërshtim me kërkesat e pikës 5, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 19, datë 10.07.2008: "Për vendosjen e disa standardeve në planifikimin e shpenzimeve për personelin";

b. Për 3 persona në vlerën 73 171 lekë, për përfitim të padrejtë për shpërblim, në kundërshtim me kërkesat e pikës 1/b të VKM nr. 591, datë 23.07.2010: "Për disiplinimin e përdorimit të fondeve buxhetore".

Emrat e personave dhe vlerat përkatëse të detyrimit janë trajtuar më hollësisht në pikën III të Raportit Përfundimtar të Kontrollit.

Menjëherë

2. Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Durrës, të kërkojë në rrugë ligjore shpërblimin e dëmit ekonomik me vlerë 230 500 lekë, përkatësisht nga [redacted] në shumën 218 130 lekë dhe [redacted] në shumën 12 370 lekë, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, për shpenzime telefonike për "thirrje ndërkombëtare", të pajustifikuara, trajtuar më hollësisht në pikën XI të Raportit Përfundimtar të Kontrollit.

Menjëherë

3. Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Durrës, të kërkojë në rrugë ligjore shpërblimin e dëmit ekonomik me vlerë 120 500 lekë, përkatësisht nga [redacted] në shumën 108 500 lekë dhe [redacted] në shumën 12 000 lekë, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, për shpenzime të telefonave celularë në kundërshtim me VKM nr. 343, 11.07.2002 "Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridikë publikë" dhe VKM nr. 864, datë 23.07.2010 "Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridikë publikë", trajtuar më hollësisht në pikën XII të Raportit Përfundimtar të Kontrollit.

Menjëherë

4. Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Durrës, të kërkojë në rrugë ligjore shpërblimin e dëmit ekonomik me vlerë 87 000 lekë, përkatësisht nga [redacted] në shumën 72 000 lekë dhe [redacted] në shumën 15 000 lekë, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, për pagesën e kontratës "Për ruajtjen e autoveturës së DSHP", për kryerjen e shpenzimeve të paligjshme, trajtuar më hollësisht në pikën XIII të Raportit Përfundimtar të Kontrollit.

Menjëherë

5. Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Durrës, të kërkojë në rrugë ligjore shpërblimin e dëmit ekonomik me vlerë 15 500 lekë, përkatësisht nga [redacted], Ahmet Sheta dhe

Avni Kalemi, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, për veprime në kundërshtim me nenin 2 të ligjit nr. 7697, datë 07.04.1993 "Për kundravajtjet administrative", trajtuar më hollësisht në pikën X të Raportit Përfundimtar të Kontrollit.

Menjëherë

D. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenet 37, 141 dhe 153 të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, nenin 44 të Ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për Kundërvajtjet Administrative", në nenin 10 të Kontratës Individuale të Punës, kërkojmë të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

I. "Vërejtje",

Për:

1. [redacted], me detyrë Shef Sek. Administrim dhe Menaxhim pranë DSHP, Durrës;

- Për aplikim në mënyrë të përsëritur të sanksioneve të ndryshme për të njëjtat shkelje të kryera nga shtetas të ndryshëm, veprim ky në kundërshtim me "Parimin e drejtësisë dhe paanësisë", neni 12 i Ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 "Kodi i Procedurave Administrative".
- Për të meta dhe mangësi të rezultuara në pikat 7 dhe 8 të Raportit Përfundimtar të Kontrollit.

2. [redacted], me detyrë jurist pranë DSHP, Durrës;

- Për moszbatim korrekt të legjislacionit në fuqi për shitjet publike nëpërmjet procedurës së ankandit, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9874, datë 14.02.2008 "Për Ankandin Publik" i ndryshuar dhe VKM nr. 1719, datë 17.12.2008.

3. [redacted], me detyre Përgjegjëse e Seksionit të Financës.

- Për moszbatim të nenit 6 të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" i ndryshuar dhe Rubrikës II, pika 3, e Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 26, datë 27.12.2007 "Për disa shtesa e ndryshime në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 14, datë 28.12.2006 Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësive që varen prej tyre si dhe njësive të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorë të huaj".

4. [redacted]**,** ish shef i Sektorit të Policisë Pyjore pranë DSHP, Durrës;

- Për veprime në kundërshtim me nenin 12 të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 "Kodi i procedurave Administrative", "Parimi i drejtësisë dhe paanësisë";
- Për veprime në kundërshtim me 1/o, neni 38 i ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005 "Për Pyjet dhe shërbimin pyjor", me ndryshime;
- Për veprime në kundërshtim me kreun III, neni 640 të ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 "Kodi Civil";
- Për veprime në kundërshtim me pikën b, neni 56 i ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999.
- Për të meta e mangësi të rezultuara në pikat V dhe X të Raportit Përfundimtar të Kontrollit.

5. [redacted]**,** inspektore finance.

- Për veprime në kundërshtim me pikën 1, neni 26 i ligjit nr. 9874, datë 14.02.2008 "Për ankandin publik";
- Për veprime në kundërshtim me udhëzimin nr. 4, datë 23.08.2007 " Për organizimin e ankandit të shitjes së lëndës drusore në pyjet publike" si dhe pikën 10, kreun II të të njëjtit udhëzim;
- Për veprime në kundërshtim me kreun II, pika I/b dhe kreun IV të VKM nr.1, datë 10.01.2007 " Rregullat e prokurimit publik";
- Për veprime në kundërshtim me pikën 1 të udhëzimit nr.2, datë 18.02.2008 "Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla";
- Për veprime në kundërshtim me 1/o, neni 38 i ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005 "Për Pyjet dhe shërbimin pyjor", me ndryshime.
- Për të meta e mangësi të rezultuara në pikat V dhe X të Raportit Përfundimtar të Kontrollit.

6. [redacted]**,** me detyrë inspektor.

- Për veprime në kundërshtim me 1/o, neni 38 i ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005 "Për Pyjet dhe shërbimin pyjor", me ndryshime.
- Për veprime në kundërshtim me kreun III, neni 640 të ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 "Kodi Civil";
- Për veprime në kundërshtim me pikën b, neni 56 i ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999.
- Për të meta e mangësi të rezultuara në pikën X të Raportit Përfundimtar të Kontrollit.

7. [redacted]**,** me detyrë inspektor.

- Për veprime në kundërshtim me pikën b, neni 56 i ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999.
- Për të meta e mangësi të rezultuara në pikat V dhe X të Raportit Përfundimtar të Kontrollit.
- Për veprime në kundërshtim me pikën 1, neni 26 i ligjit nr. 9874, datë 14.02.2008 "Për ankandin publik";
- Për veprime në kundërshtim me kreun III, neni 640 të ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 "Kodi Civil";

Shënim : *Sqarojmë se, për* [redacted]*, masa disiplinore: "Ndërprerje e mardhënieve të punës", konsiderohet e ezauruar, bazuar në urdhrat e poshtëshënuara të Ministrit të MMPAU, ku u janë dhënë masat si vijon:*

- *Urdhër nr. 621, datë 15.07.2010 është liruar nga detyra* [redacted]*, për shkaqe të justifikuara;*
- *Urdhër nr. 872, datë 08.04.2010 është liruar nga detyra* [redacted] *me kërkesën e tij për dorëheqje, dhe*
- *Urdhër nr. 421, datë 24.06.2011 është liruar nga detyra* [redacted]*, për shkaqe të justifikuara.*

Lista me emrat e lartpërmendur [redacted] ***do t`i dërgohet Departamentit të Administratës Publike (DAP)***

Shënim: Auditimi i krye nga audituesit Elfrida Taraku, Edmond Gjini, Selman Hysi, Mirosh Bogdo, Teuta Qatipi, më tej u shqyrtua nga k/auditues Mimoza Lloji, Drejtori i Departamentit Athanas Karaja, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë Elvana Tivari, si dhe u verifikua si praktike nga Drejtori i Përgjithshëm Robert Gjini.